

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1233 Prot.

Tiranë, më 05.12 2016

**VENDIM Nr. 135, datë 22.11.2016**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13 të datës 22.11.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi verifikimin në terren të gjetjeve arkeologjike*, të konstatuara gjatë punimeve të zbatimit të projektit "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza" Sarandë, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

**VENDOSI:**

1. Të kryhet nga shoqëria e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k. dokumentimi i strukturave të mureve të zbuluara, gjatë zbatimit të projektit "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza", Sarandë. Raporti i tyre të sillet në KKA e radhës.
2. Shoqëria e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k., të marrë masat për ruajtjen e këtyre strukturave, nëpërmjet mbulimit të tyre dhe të sistemohet territori i prekur nga ndërhyrjet e punimeve zbatuese.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO